**VENDIM**
**Nr. 72, datë 10.5.2019**

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "SMART WATT" SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw, NË ZONËN SHEQ MARINAS, NJËSIA ADMINISTRATIVE TOPOJË, BASHKIA FIER**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa "a"; neni 5, pika 1, germa "a"; neni 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", neni 15 i "Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi licencimin e shoqërisë "Smart Watt" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw, në zonën Sheq Marinas, njësia administrative Topojë, Bashkia Fier,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 50, datë 27.3.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë "Smart Watt" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, për një afat 25-vjeçar.

- Shoqëria "Smart Watt" sh.p.k., është një subjekt përfaqësues në cilësinë e mbajtësit të miratimit përfundimtar me nr. 5864/11, datë 14.11.2018. Kjo shoqëri është e regjistruar pranë QKB-së, në datën 20.11.2017, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.), konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", me numër identifikimi (NUIS) L72320013B.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 7.10.2015, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike", që nuk janë objekt koncesioni, i ndryshuar. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë i jep të drejtën e financimit, projektimit, ndërtimit e vënies në punë me kapacitet prodhues 2 mw.

- Objekt i veprimtarisë së "Smart Watt" sh.p.k., është ndër të tjera edhe kryerja e aktivitetit të importit, eksportit, tregtimit, dhe furnizimit me shumicë dhe pakicë të energjisë elektrike si brenda dhe jashtë Shqipërisë. Ndërtimin e impianteve të energjisë së rinovueshme, prodhimin e energjisë, studimin dhe konsulencën në aktivitetin e energjisë elektrike. Kryerja e çdo aktiviteti të lejuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.

- Aplikimi i bërë nga shoqëria "Smart Watt" sh.p.k., për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b", "c") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d", "e", "f", "g") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c", "d" ) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik, për centralet solare (neni 9, pikat 4.4.1, 4.4.2, 4.4.3, germat "a", "b", "c", "d"; 4.4.4, germat "a", "b", "c", "d"; 4.5, germa, "b") është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Në lidhje me parashikimet e nenit 9, pika 4.5, germa "a" (miratimin e OST-së ose OSHEE-së, për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit ose shpërndarjes), shoqëria ka aplikuar për

marrjen e miratimit pranë OSHEE-së dhe kjo e fundit ka rekomanduar lidhjen në rrjetin e transmetimit.

- Në nenin 27, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, parashikohet se, operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes duhet të sigurojnë lidhjen me rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes mbi kushte jodiskriminuese.

- Sa më sipër, e drejta e çdo përdoruesi të rrjetit për akses në rrjetin e shpërndarjes apo të transmetimit është e garantuar me ligj.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Smart Watt" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me fuqi të instaluar 2 mw, në zonën Sheq Marinas, njësia administrative Topojë, Bashkia Fier për një afat 25-vjeçar.

2. Para vënies në punë të centralit, shoqëria "Smart Watt" sh.p.k., të depozitojë në ERE miratimin e pikës së lidhjes me rrjetin e transmetimit apo shpërndarjes.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim, mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike dhe mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**